

Pjesa e parë

Përgjigjuni duke e rrethuar shkronjën para një nga opsionet e dhëna. Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve si dhe shlyerja përgjigjes do të vlerësohet me 0 pikë. Çdonjëra përgjigje e saktë sjell 2 pikë.

- Avullimi është:
 - ndryshim prej të ngurtë në të lëngët
 - ndryshim prej të lëngët në të ngurtë
 - ndryshim prej të lëngët në të gaztë
 - ndryshim prej të ngurtë në të gaztë
 - njëlloj sikur edhe vlimi
- Procesi i difuzionit të gazrave është:
 - spontan
 - jospontan
 - i shpejtë
 - i ngadalshëm
 - kimik
- Materiali që është i farkëtueshëm dhe përçon elektricitet mesiguri është i përpunuar prej:
 - druri
 - akulli
 - metali
 - vaj motori
 - qelqi
- Cila listë e elementeve përmban vetëm metale?
 - klor, karbon, bakër
 - litium, krom, bakër
 - jod, hekur, natrium
 - fosfor, karbon, sulfur
 - hidrogjen, oksigjen, azot
- Bronza është legurë e:
 - bakrit dhe aluminit
 - bakrit dhe zinkut
 - kallait dhe plumbit
 - kallait dhe bakrit
 - zinkut dhe kallait
- Simboli i elementit të bakrit është:
 - Co
 - Cu
 - Cl
 - Ca
 - Ba
- Substancat e thjeshta janë të ndërtuara prej:
 - një atomi
 - një molekulë
 - një njësi formulare
 - atome të një lloji
 - molekula të një lloji
- Ngjyrosje e kuqe e flakës vërehet gjatë nxehtjes së komponimeve të:
 - bakrit
 - bariumit
 - natriumit
 - kaliumit
 - litiumit
- CaSO₄ është formulë kimike e:
 - sulfur kaliumit
 - sulfat kaliumit
 - sulfur kalciumit
 - sulfat kalciumit
 - sulfurur kalciumi
- Me filtrim **nuk mundet** të ndahen komponentët nga përzierja e ujit dhe:
 - rërë
 - gozhda hekuri
 - miell
 - sulfur
 - sheqer
- Cili prej ndryshimeve vijuese është kimik?
 - avullimi i ujit
 - vlimi i ujit
 - ngrirja e ujit
 - zbërthimi i ujit
 - sublimimi i ujit
- Barazim i përgjithshëm i një reaksioni është $A + B \longrightarrow C$. Sa masë e produktit do të fitohet nëse 12g A plotësisht reagojnë me 9g B?
 - 12 g
 - 9 g
 - 21 g
 - 108 g
 - Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për ta përcaktuar.

13. Cili prej këtyre barazimeve tekstuale i përshtatet reaksionit të përfitimt të kripës?

- A. magnez + klor \longrightarrow klorur magnezi
 B. magnez + oksigjen \longrightarrow oksid magnezi
 C. hidrogjen + klor \longrightarrow klorhidrik
 D. klorur magnezi \longrightarrow magnez + klor
 E. magnez + avull i nxehtë \longrightarrow oksid magnez + hidrogjen



14. Simboli tregon:

- A. substancë toksike
 B. substancë irrituese
 C. substancë korozive
 D. mjet dezinfektues
 E. mjet oksidues

15. Indikator i universal në tretësirë të acidit klorhidrik është i ngjyrosur _____, ndërsa lakmushi _____:

- A. kaltërt, kuq
 B. kaltërt, kaltërt
 C. kuq, kaltërt
 D. kuq, kuq
 E. gjelbërt, vjollcë

Pjesa e dytë


Përgjigju në përputhshmëri me kërkesat e paraqitura në pyetje. Të shkruarit me laps ose shlyerja e përgjigjes do të vlerësohet me 0 pikë

1. Rretho PO ose JO në varësi nga saktësia e pohimit. (5 pikë)

- A. Disa veti fizike të substancave mund të regjistrohen me sy të lirë. **PO JO**
 B. Të gjitha vetitë kimike të substancave mund të shihen me sy të lirë. **PO JO**
 C. Uji i destiluar përzihet më të gjitha lëngjet. **PO JO**
 D. Në natyrë ka me tepër metale sesa jometale. **PO JO**
 E. Të gjitha substancat e thjeshta të njohura janë të ngurta në 0°C. **PO JO**

2. Përgjigju në pyetjet e parashtruara A—C. (4 pikë)

A. Në cilën fotografi janë të paraqitura thërmija të përzierjes? Rretho shkronjën nën fotografinë përkatëse.




B. Sqaroje përgjigjen e pyetjes nën A.

a – substancë e pastër (komponim), b- substancë e pastër (substancë e thjeshtë), c – substanca të ndryshme

C. Në katrorët mëposhtë, me ndihmën e dijagramëve korpuskular, duke përdorur rathë për të shënuar një atom, vizato:

- dy molekula treatomike të komponimit
- tre molekula dyatomike të ndërtuara nga lloji i njejtë dhe një molekulë katëratomike të ndërtuar prej atomeve të llojeve të ndryshme.

C – pranohen edhe përgjigje të ndryshme, por të sakta! (1 pikë)



3. Në përbërje të sulfhidrikut hyjnë elementet: _____ (emri kimik), simboli kimik i të cilit është _____ dhe _____ (emri kimik), simboli kimik i të cilit është _____. Simbolet/formulat e substancave të thjeshta të cilat janë të ndërtuara nga këto elemente janë: ____ dhe _____. (3 pikë)

Hidrogjen, H, sulfur, S, H_2 , S_8

4. Emërto komponimet vijuese të paraqitura me formulat kimike: (5 pikë)

- A. K_2CO_3 Karbonat kaliumi
 B. $Mg(OH)_2$ Hidroksid magnezi
 C. NO_2 Dioksid azoti
 D. Cl_2O_7 Heptaoksid diklori
 E. $CuCl_2$ Klorur bakri

5. Plotëso tabelën vijuese ashtu që do ta shënosh ngjyrën e indikatorit universal në të gjitha tretësirat.

(3 pikë)

Tretësirë	Ngjyrë
bikarbonati i sodës	e kaltër
acid sulfurik	e kuqe
lëng prej limoni	e kuqe në të kaltër
ujë i destiluar	e gjelbër
koka-kolë	e portokalltë
kripë në ujë	e gjelbër